

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

BT Solutions

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K41914024V

NUIS/NIPT

Rruga Hoxha Tahsim, Nr. 62/5

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0684030028

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

meriedi@yahoo.com

E-mail

Administrator Merita Halla

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/07/17

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0684030028

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-53606-07-07-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

824900

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Loti 7 - Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Chest /ose ekuivalent

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/08/07

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2025/08/07

Numri i njoftimit

CN/66692/07072025

Kodi CPV

50000000-5 - Shërbime mirëmbajtje dhe ripar

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

LPP 162/2020, neni 109 i tij dhe ne vijim si edhe VKM 285/2021. AK ka hartuar DST dhe kriteret e saj ne kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik ne fuqi

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

AK Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane ka publikuar ne SPE ne daten 08.07.2025 proceduren e prokurimit te ndare ne lote “Mirëmbajtjen Full Risk për një periudhë 24 mujore të pajisjeve të vogla mjekësore të QSUNT” dhe nder to Loti 7 - Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues CHest/ose ekuivalent”, me fond limit 824.900 Lekë dhe eshte me date te zhvillimit ne daten 07.08.2025 ora 10.00.

Nga konsultimi me keto dokumenta tenderi na rezulton se ato nuk jane hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Shoqeria jone e paraqet kete ankese sot me date 17.07.2025, sipas afateve ligjore te percaktuara ne ligjin 162/2020, neni 110, brenda afatit 10 ditor nga publikimi i njoftimit te kontrates qe ne kete rast eshte bere ne daten 08.07.2025, per rastin e procedurave te prokurimit mbi kufirin e larte monetar ne rastin e ankesave per dokumentat e tenderi.

Per kete arsye sqarojme se kjo ankese eshte e ligjshme dhe ne afatet e caktuara ligjore dhe meqe kemi interes per kete procedure prokurimi si te tille legjitimohemi per ta paraqitur ate prane AK dhe KPP.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Ne vijim do te paraqesim argumentat e shoqerise tone “BT Solutions” shpk lidhur me kete lot te kesaj procedure sa i takon kriterereve te hartuara per kete procedure prokurimi.

? Ne piken 2.3/a te shtojces 9 te DST eshte percaktuar nga AK kriteri si me poshte:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik per shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vleres së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen shërbimet.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet”.

AK në këto kriter ka kërkuar në rastin e dëshmi me një ent publik, të paraqiten vërtetimet, kontrata dhe /ose fatura tatimore.

Për AK në këto rast ka kërkuar me shumë dokumenta se sa parashikohen në legjislacionin e prokurimit publik, ndërkohë që vete legjislacioni ka krijuar lehtësira për operatorët ekonomikë me qëllim lehtësimin e një pjesëmarrje të gjere në procedurat e prokurimit,

Kriteret për kualifikim vendosen nga AK dhe i shërbejnë atij për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë që në bazë të dokumentacionit që do të paraqesin në një procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë që zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe stafin dhe personelin e nevojshëm gjithëkrah në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, por kjo gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Në varësi të kontratës, objektit të saj, volumit dhe natyrës, AK përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga AK duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar llojit të kësaj procedure që është shërbim, citojmë nenin 41/2/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Sa më sipër edhe vete lpp dhe vkm përcaktojnë që duhet të kerkohen vërtetime realizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes në rastin e procedurave të prokurimit me objekt shërbim për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, pasi AK e mer informacionin e duhur edhe vetëm nga këto dokumenta, për më tepër që ai në bazë të ligjit mund të bëjë në çdo kohë verifikimet e duhura për dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Mendojme qe kjo kerkese duhet te hiqet si e tepert dhe penguese pasi edhe nga vertetimi i realizimit dhe/ose faturat tatimore meret i gjithë informacioni i duhur dhe nevojshem per AK.

AK nuk duhet te perdore kriteret qe nuk jane ne proporcion me objektin dhe natyren e objektit te prokurimit si edhe ne kundërshtim me percaktimet e bera ne VKM 285.

Ne perfundim kerkojme modifikimin e ketij kriteri duke u hequr kriteri per kontratat, ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi sic cituam me siper, me qellim mospengimin e konkurrencës dhe diskriminimin e operatoreve ekonomike te interesuar.

? Ne piken 2.3/b te shtojces 9 eshte percaktuar nga AK kriteri si me poshte:

b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

*Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

*Shënim: Ky kriter ne fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i permbyllur me dorëzimin/paraqitjen e formularit permbylës të vetdeklarimit sipas shtojces 10 të DST. Ne rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

Sic pershkruam edhe me lart kriteret per kualifikim vendosen nga AK dhe i shërbejnë atij për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë që në bazë të dokumentacionit që do të paraqesin në një procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë që zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe stafin dhe personelin e nevojshëm gjithëcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK duhet te vendosr kriteret te tilla qe te jene ne proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës, me qellim qe edhe te stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Ky kriter ka disa probleme, ne lidhje me numrin e percaktuar per punonjesit si edhe me certifikatat e kerkuara per trajnimin e punonjesve.

Per numrin e punonjesve te percaktuar ne kete kriter konstatojme se eshte e tepert percaktimi i 2 punonjesve te tille kur nisur nga objekti dhe puna qe duhet bera si edhe nga eksperienca qe kemi gjykojme se sherbimi i mirembajtjes mund te behet mjaft mire edhe me nje punonjes ne perputhje dhe me numrin e vogel te pajisjeve qe do te mirembahen.

Edhe KPP ne vendimmarrjet e saj te meparshme ne raste te tilla te ngjashme ka mbajtur te njejtin qendrim qe numri i punonjesve duhet te vendoset ne perputhje me volumen dhe objektin e prokurimit dhe nuk mund te jete i ekzagjeruar dhe i paargumentuar sipas natyren se prokurimit dhe sherbimit qe do te kryhet.

Ne kete kuptim kerkojme modifikimin e ketij kriteri duke ulur numrin e punonjesve nga 2 (dy) ne 1 (nje) sipas argumentave si me siper cituar me qellim heqjen e kriterave diskriminuese dhe jo ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, dhe jo ne proporcion me objektin, volumin dhe natyren e procedures se prokurimit, apo vendimmarrjen e KPP si organi me i larte ne fushen e prokurimit publik. (per reference Vendimi KPP Nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me Nr. 1845/5 Prot).

Nga ana tjeter, AK ka kerkuar: paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit.

Edhe ky percaktim eshte diskriminues dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

Në varësi të kontratës, volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë të interesuar për atë procedurë prokurimi.

Sic kemi cituar edhe me lart kriteret per kualifikim bazuar ne parimet e LPP (mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i kandidatëve / ofertuese, transparencë, barazia), duhet qe te jenë gjithëpërfshirëse dhe te stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe LPP.

Edhe ne kete rast do te referonim vendimin e KPP Nr. 1228/2024, datë 10.09.2024, me Nr. 1845/5 Prot, i cili ne nje rast te ngjashem procedure sherbimi ka konsideruar si diskriminuese kriteret te tilla dhe ka vendosur heqjen e tyre.

Gjykojme qe duke u bazuar edhe ne parashikimet ligjore ne fuqi nenin 36 te LPP mbi termin ekuivalent, kerkojme qe AK duhet te kerkoje dokumentacion per punonjes te trajnuar dhe certifikuar jo ne menyre eksplicite vetem per pajisjen mjekesore Chest per te cilen kerkon sherbimin e mirembajtjes por duhet te percaktoje termin ekuivalent, persa kohe edhe ne objektin e prokurimit te ketij loti vete AK e percakton kete objekt "Shërbim mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Chest /ose ekuivalent".

Sa me siper AK nuk duhet te percaktoje kriteret kufizuese dhe penguese per shoqerite e interesuara per te marre pjese ne kete procedure prokurimi pasi ka ngushtuar konkurrencen dhe demton padrejtesisht shoqerite qe kane nje eksperience ne kete fushe dhe kane interes te marin pjese ne kete procedure prokurimi.

AK ne hartimin e kriterave duhet te mbaje ne konsiderate edhe rekomandimet e APP vecanerisht ne rastin kur sugjeron perdorimin e termit "ekuivalent" ne procedura kur kemi te bejme me karakteristika malli apo sherbimi (psh rekomandimi i APP date 20.03.2018 nr. 3341/1 prot.).

Mendojme qe AK ne ate menyre qe ka titulluar objektin e prokurimit duhet te kishte hartuar edhe kete kriter per kualifikim.

Sa me siper kerkojme te shtohet fjala ekuivalent per trajnimet e stafit per pajisjet mjekësore për të cilat do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizimin e vendosjes së pjesëve të këmbimit/ose ekuivalent, pra AK te percaktoje kriterin:

Te paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore/ose ekuivalent, të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit.

AK nuk ka argumentuar dhe arsyetur vendosjen e nje kriteri te tille ne DST ndaj kerkojme te heqë

një kriter të tillë ose të përcaktojë fjalën ekuivalent me qëllim mosdiskriminimin dhe moskufizimin e konkurrencës dhe heqjen e kriterëve diskriminues dhe jo në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

? Ne piken 2.3/c të shtojcës 9 të DST, nga AK është përcaktuar kriteri si më poshtë:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jete original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave”.

Ky kriter është diskriminues dhe jo në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

Sikurse thame më lart kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë që nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, besueshmerinë, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjykojmë se ky kriter duhet të hiqet pasi vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik.

AK ka kërkuar që Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar .

Pra, AK ka kërkuar që ky dokument duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar.

Sqarojmë se në dokumentat e tenderit AK ka përcaktuar që

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip	X	Anglisht	X
-------	---	----------	---

LPP dhe RrPP përcaktojnë qartazi rastet e përcakimit të gjuhës në të cilën mund të hartohen ofertat.

Gjithashtu, edhe në DST Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, është përcaktuar Gjuha e ofertës, ku citohet se: “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës?.. Në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze”.

Ndërsa me VKM nr. 498, datë 01.08.2024, është përcaktuar si më poshtë vijon:

“Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të

hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht”.

Sa me sipër, legjislacioni përcakton se në procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë AK përcakton të dyja gjuhët dhe një ofertë kualifikohet edhe nëse një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit do të paraqesë një pjesë të dokumentacionit në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

Me këtë kuptim kërkojmë të hiqet kriteri për perkthimin në gjuhën shqipe dhe noterizimit, pasi edhe vetë AK në DST ka përcaktuar se gjuha e ofertes është shqip dhe anglisht, sikurse është përcaktuar edhe në rregullat e prokurimit publik, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetarë si kjo procedurë që ka publikuar AK.

? Në pikën 2.1/c të shtojcës shtojcën 9, është përcaktuar nga AK kriteri si më poshtë:

c) OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Gjykojmë se ky kriter në këtë procedurë prokurimi është i tepert dhe diskriminues dhe jo në përputhje me objektin dhe natyrën e kësaj procedurë prokurimi.

AK në hartimin e dokumentave të tenderit duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e LPP ku janë përcaktuar qëllimet dhe parimet e përgjithshme.

AK është përgjegjës për të hartuar dokumentat e tenderit po gjithnjë në përputhje me qëllimin e këtij ligji dhe parimet e përcaktuara por gjithashtu duke garantuar mosdiskriminim dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencën etj.

AK bazuar në nenin 40/3 të VKM 285/2021 duhet të mbajë në konsideratë se kriteri për kualifikim AK i shërbejnë me qëllim që të njohe gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë të cilët me dokumentacionin e paraqitur vërtetojnë se kanë kualifikimet e duhura për të realizuar me sukses një kontratë.

Ashtu siç edhe KPP shprehet në vendimet e tij, AK harton dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, por kjo gjithnjë në përputhje e përputhshëm me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Pra, në varesi të disa elementeve siç janë objekti i kontratës, volume, natyra e tij, AK duhet të hartojë DST dhe të përcaktojë kriteret për kualifikim ku vendosja e këtyre kriterëve nga AK duhet të jetë në proporcion me këto elemente dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK gjatë hartimit të DST duhet të mbajë në konsideratë raportin e arsyeshëm që duhet të ekzistojë në kriteret e vendosura dhe të mbajë në konsideratë që të jenë të tilla që të mos përjashtojnë asnjë operator ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në procedurë e prokurimit me qëllim që të stimulojë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm siç përcakton edhe lpp dhe rregullat e prokurimit publik duke mos u bërë pengesë dhe të krijojë kufizim të konkurrencës për shoqëritë e interesuara.

Në këtë kuptim mendojmë se kërkesa për autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtimin e pajisjeve mjekësore është e tepert dhe nuk lidhet me këtë objekt prokurimi që ka për qëllim shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore ndaj kjo kërkesë e AK është

diskriminuese dhe ne kundershtrimet

Per kerkesen e përcaktuar nga AK per Autorizimin e MSHMS për tregëtim të pajisjeve mjekësore, referuar objektit të prokurimit dhe volumit të kontratës objekt prokurimi, për më tepër objektit të prokurimit gjykojmë se kjo kërkesë e AK është e tepert dhe e paqarte per arsyet se perse eshte kerkuar ne kete procedure prokurimi, si edhe jo në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës.

Kjo eshte nje procedure prokurimi sherbimi dhe nuk ka pse te kerkohet autorizim per tregetim pajisjesh kur objekti i prokurimit nuk eshte per blerje pajisje mjekesore.

Ne kete kuptim kerkojme qe kjo kerkese duhet te hiqete nga dokumentat e tenderit pasi eshte ne kundershtrim me parimet dhe qellimin e ligjit dhe jo ne proporcion me objektin dhe natyren e ketij objekti prokurimi.

Sipas legjislacionit ne fuqi AK duhet te argumentoje dhe arsyetoje cdo kriter dhe kerkese qe percakton ne dokumentat e tenderit duke arsyetuar edhe per bazen ligjore ku e mbeshtet vendosjen e nje kriteri si edhe arsyen e domosdoshmerise se vendosjes se tij dhe ne kete llogjike AK nuk e ka argumentuar nje gje te tille as ne argumentimin e hartimit te kriterëve per kualifikim.

Si perfundim kerkojme heqjen e kesaj kerkese si diskriminuese, te tepert dhe jo ne perputhje me kete objekt prokurimi.

Per te gjitha argumentimet tona te dhena me lart kerkojme qe AK te beje modifikimin e kriterëve duke hequr dhe modifikuar kriterë qe vijne ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi, sipas arsyetimeve tona te bazuara dhe mbeshtetura ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi pengojne dhe ulin konkurrencen dhe pjesemarrjen e operatoreve ekonomike qe kane interes te marrin pjese ne keto procedura prokurimi.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi asnje kerkese per perjashtim te ndonje zyrtari qe do te merret me shqyrtimin e ankeses.

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

Cdo dokumentacion i shoqerise BT Solutions shpk pasi eshte dokumentacion qe i perket shoqerise

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. □

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

meriedi@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Merita Halla